



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit
dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 13 dhjetor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Nxjerrjen e Informacionit të
Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Zyrës Administrative
Shefit të ZMMD-së
Shefes së ZPV-së

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(2), 23(1) dhe 39(11) dhe (13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 80, 95(2)(h), 113 dhe 114 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 janar 2021 dhe më 6 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi dy vendime kornizë të cilat përcaktonin parimet që rregullojnë procesin e pranimit të viktimave pjesëmarrëse në procesin gjyqësor kundër katër të akuzuarve (“të akuzuarit” ose “Mbrojtja”) në këtë çështje (“Vendimi i Parë Kornizë” dhe “Vendimi i Dytë Kornizë”).²

2. Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi katër vendime për pjesëmarrjen e viktimave dhe pranoi gjithsej 53 viktima për të marrë pjesë në procesin gjyqësor (“viktimat pjesëmarrëse”) dhe refuzoi 28 kërkesa.³

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00159, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat*, 4 janar 2021, publik; F00382, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat*, 6 korrik 2021, publik.

³ KSC-BC-2020-06, F00257, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (“Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”), 21 prill 2021, konfidencial, para. 85(a), (f). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00257/RED; F00611, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (“Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”), 10 dhjetor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 70(b). Versionet e redaktuara konfidenciale dhe publike u dorëzuan po atë ditë, F00611/CONF/RED dhe F00611/RED; F00817, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (“Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”), 25 maj 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 50(a). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00817/RED; F01152, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (“Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”), 12 dhjetor 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

3. Më 21 shkurt 2022, Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit") dorëzoi një mocion për nxjerrjen e informacionit të dëshmitarëve me status të dyfishtë ("Kërkesa").⁴
4. Më 3 mars 2022, përkatësisht, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dhe mbrojtësi i viktimave iu përgjigjën Kërkesës ("Përgjigjja e ZPS-së" dhe "Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave").⁵
5. Më 8 mars 2022, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një kundërpërgjigje përmbledhëse ndaj Përgjigjes së ZPS-së dhe Përgjigjes së Mbrojtësit të Specializuar ("Kundërpërgjigjja").⁶
6. Më 15 shtator 2022, në vijim të apelit të Mbrojtjes së Kadri Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave,⁷ Gjykata e Apelit konfirmoi standardin ligjor që Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte zbatuar për miratimin e masave mbrojtëse ("Vendimi i Gjykatës së Apelit").⁸

II. PARASHTRIMET

A. KËRKESA E MBROJTJES SË THAÇIT

7. Mbrojtja e Thaçit kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të urdhërojë të nxirren për Mbrojtjen të kodeve të dëshmitarëve dhe formularëve të kërkesave të

⁴ KSC-BC-2020-06, F00706, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 21 shkurt 2022, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00722, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 3 mars 2022, publike; F00723, Mbrojtësi i Viktimave, *Përgjigje e Mbrojtësit të Viktimave ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 3 mars 2022, publike.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00728, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje Përmbledhëse e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjeve të Prokurorisë dhe Mbrojtësit të Viktimave në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 8 mars 2022, konfidenciale.

⁷ KSC-BC-2020-06, IA023/F00002, Mbrojtësi i Specializuar, *Apel i Ndërmjetëm i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 12 korrik 2022, publik.

⁸ KSC-BC-2020-06, IA023/F00006, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat ("Vendimi i Gjykatës së Apelit")*, 15 shtator 2022, publik, para. 32, 52-52. Versioni i korrigjuar u dorëzua po atë ditë, IA023/F00006/COR.

dëshmitarëve me status të dyfishtë, konkretisht, dëshmitarët në listën e dëshmitarëve të ZPS-së që janë autorizuar të marrin pjesë si viktime (“dëshmitarët me status të dyfishtë”). Mbrojtja e Thaçit parashtron se, meqenëse formularët e kërkesave të viktimave nuk janë nxjerrë për ZPS-në, dhe mund të mos jetë në dijeni të identitetit të tyre, duhet të zbatohet një sistem i ngjashëm me atë që përdoret në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (“GJPN”).⁹ Rrjedhimisht, Mbrojtja e Thaçit kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. të urdhërojë ZPS-në, Zyrën Administrative dhe mbrojtësin e viktimave të kontaktojnë sa më shpejt njeri-tjetrin për të identifikuar dëshmitarët me status të dyfishtë;
- b. të urdhërojë Zyrën Administrative t’i japë ZPS-së të gjithë formularët e kërkesave të dëshmitarëve me status të dyfishtë, së bashku me dokumentet mbështetëse, në formë të përdiktuar; dhe
- c. të urdhërojë ZPS-në të bëjë redaktime, nëse është e nevojshme, në përputhje me sistemin e redaktimeve të përcaktuar në Vendimin e Parë Kornizë dhe të nxjerrë për Mbrojtjen formularët e kërkesave dhe dokumentet mbështetëse të përmendura më lart.¹⁰

8. Mbrojtja e Thaçit parashtron se rregullat 113 dhe 114 të Rregullores përcaktojnë modalitetet e pranimit të viktimave për pjesëmarrje në procesin gjyqësor dhe se, në bazë të nenit 22(6) të Ligjit, Dhomat e Specializuara (“DHS”) “duhet të sigurojnë që pjesëmarrja e viktimave në procesin gjyqësor të mos cenojë të drejtat e të akuzuarve dhe mos të bjerë ndesh me të drejtat e të akuzuarve”.¹¹ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit argumenton se, në bazë të rregullës 80 të Rregullores, masat për mbrojtjen e viktimave duhet të jenë “në përputhje me të drejtat e të akuzuarve” dhe në bazë të rregullës 81 të Rregullores, që përcakton kuadrin ligjor

⁹ Kërkesa, para. 1.

¹⁰ Kërkesa, para. 1, 15-16.

¹¹ Kërkesa, para. 2-3.

që zbatohet për ndryshimin e masave mbrojtëse, masat mbrojtëse “nuk e pengojnë Prokurorin e Specializuar që të përmbushë çfarëdo detyrimi për nxjerrje informacioni”.¹²

9. Mbrojtja e Thaçit më tej parashtron se, në përputhje me detyrimet e ZPS-së për nxjerrjen e informacionit, duhet që ZPS-ja: (i) në bazë të rregullës 102(1)(b)(i) të Rregullores, të nxjerrë për Mbrojtjen brenda afatit të përcaktuar nga Trupi Gjykses, dhe jo më vonë se tridhjetë ditë përpara hapjes së çështjes nga ZPS-ja, deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që ZPS-ja synon t’i thërrasë për të dëshmuar në gjykim; (ii) në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores, të nxjerrë për Mbrojtjen, sipas kërkesës dhe pa vonesë, çfarëdo deklarate ose dokumenti nën ruajtjen ose kontrollin e ZPS-së, që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për t’u përgatitur; dhe (iii) në bazë të rregullës 103 të Rregullores, të nxjerrë menjëherë për Mbrojtjen çdo informacion që mund të ndikojë në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar, sapo një informacion i tillë të jetë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të Prokurorit të Specializuar.¹³ Mbrojtja e Thaçit parashtron, meqenëse formularët e kërkesave të dëshmitarëve me status të dyfishtë janë deklarata të mëparshme të dëshmitarëve që ZPS-ja synon t’i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, në të cilat saktësohet se si parashtruesit e kërkesave i përmbushin kriteret si viktimë dhe japin vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm në përputhje me rregullën 113(1) të Rregullores, ato duhet të nxirren për Mbrojtjen në bazë të këtyre rregullave.¹⁴

10. Mbrojtja e Thaçit parashtron se as Ligji, as Rregullorja nuk përcaktojnë kuadrin ligjor që zbatohet për dëshmitarët me status të dyfishtë. Meqenëse DHS-ja nuk ka vendosur në lidhje me aspektin e nxjerrjes së formularëve të kërkesave

¹² Kërkesa, para. 4-5.

¹³ Kërkesa, para. 6, 14.

¹⁴ Kërkesa, para. 14.

të dëshmitarëve me status të dyfishtë, Mbrojtja e Thaçit parashtron se jurisprudenca e GJPN-së është relevante, e cila, sipas saj, parasheh se, ndonëse dëshmitarët me status të dyfishtë mund të përfitojnë nga masat mbrojtëse, kjo nuk duhet të pengojë nxjerrjen e identitetit dhe formularëve të kërkesave për Mbrojtjen nga ZPS-ja, në përputhje me detyrimin e ZPS-së për nxjerrjen e informacionit.¹⁵

11. Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashtron se, ndërsa Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë një kërkesë paraprake nga Mbrojtja për nxjerrjen e formularëve të kërkesave të dëshmitarëve me status të dyfishtë duke e konsideruar atë të parakohshme, drejtësia e gjykimit kërkon që të nxirren për Mbrojtjen emrat dhe formularët e kërkesave të dëshmitarëve me status të dyfishtë, pasi ZPS-ja ka dorëzuar listën e dëshmitarëve dhe dosjen e vet paraprake.¹⁶

B. PËRGJIGJJA E ZPS-SË

12. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie ndesh me kornizën e zbatueshme dhe nuk vërteton se përlicjet ndryshimi i masave mbrojtëse.¹⁷ ZPS-ja parashtron se procedura e propozuar nga Mbrojtja, konkretisht ajo që zbatohet në GJPN, bazohet në dispozita të tjera ligjore dhe nuk është e zbatueshme për DHS-në. Në veçanti, ZPS-ja parashtron se, ndërsa rregulla 89(1) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të GJPN-së përcakton shprehimisht

¹⁵ Kërkesa, para. 7-11 i referohet ICC, *Prosecutor v. Alfred Yekatom and Patrice-Edouard Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-339, Pre-Trial Chamber II, [Decision on Motion for Disclosure of Witnesses with Dual Status](#), 13 September 2019, paras 10-11; *Prosecutor v. Al Hassan Ag Abdoul Aziz Ag Mohamed Ag Mahmoud*, ICC-01/12-01/18-536, Trial Chamber X, [Decision on the Prosecution request for access to the identity and applications of participating victims and inviting report and submissions on victim application procedure](#), 20 December 2019, paras 10-11; *Prosecutor v. Laurent Gbagbo and Charles Blé Goudé*, ICC-02/11-01/15-915-Red, Appeals Chamber, [Public Redacted Version of Judgment on the appeal of Mr Laurent Gbagbo against the oral decision on redactions of 29 November 2016](#), 31 July 2017, para. 60.

¹⁶ Kërkesa, para. 12-13.

¹⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 1.

nxjerrjen e formularëve të kërkesave të viktimave, rregulla 113(1) e Rregullores përcakton se, në DHS, këta formularë nuk u bëhen të njohur palëve.¹⁸

13. ZPS-ja parashtron se, kur miratoi anonimitetin për viktimat pjesëmarrëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mori parasysh se nxjerrja e çdo materiali ose informacioni që çon në identifikimin e tyre për publikun dhe për palët, përbën rrezik objektivisht të arsyetueshëm për ta dhe anëtarët e familjeve të tyre, duke theksuar se çdo status i dyfishtë i mundshëm kishte efekt të vogël në aftësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur.¹⁹ Gjithashtu, ZPS-ja vë në dukje se vazhdon procesi i paraqitjes së kërkesave për pranim si viktimë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe numri i mundshëm i dëshmitarëve me status të dyfishtë është relativisht i kufizuar. ZPS-ja shton se, në bazë të rregullës 102(1)(b) të Rregullores, kushtëzuar nga masat mbrojtëse të domosdoshme dhe proporcionale të autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja ka marrë tashmë, ndër të tjera, deklaratat e dëshmitarëve që ZPS-ja synon t'i thërrasë, përfshirë ata me status të dyfishtë.²⁰ ZPS-ja thekson konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se masat mbrojtëse të autorizuara për viktimat pjesëmarrëse nuk cenojnë ndonjë ndryshim të domosdoshëm në një fazë të mëvonshme, përfshirë dhe nga Trupi Gjykses. Së fundi, ZPS-ja argumenton se në Kërkesë nuk jepen arsye për ndryshimin e masave mbrojtëse duke marrë parasysh: (i) fazën e procesit, përfshirë faktin se nuk është caktuar ende data për fillimin e gjykimit; (ii) se vazhdon procesi i paraqitjes së kërkesave për pranim si viktimë para Trupit Gjykses; (iii) dëmin e vogël, nëse do të ketë, që i shkaktohet Mbrojtjes; dhe (iv) rreziqet reale dhe objektive ndaj viktimave pjesëmarrëse.²¹

¹⁸ Përgjigja e ZPS-së, para. 2 i referohet gjithashtu nenit 218(2) të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

¹⁹ Përgjigja e ZPS-së, para. 3.

²⁰ Përgjigja e ZPS-së, para. 3.

²¹ Përgjigja e ZPS-së, para. 4.

C. PËRGJIGJJA E MBROJTËSIT TË VIKTIMAVE

14. Mbrojtësi i viktimave kundërshton Kërkesën, duke theksuar se nuk përputhet me kushtet e rregullës 113(1) të Rregullores.²² Mbrojtësi i viktimave shton se Mbrojtja e Thaçit nuk e ka trajtuar këtë dispozitë, as nuk ka shpjeguar se si është në përputhje me Kërkesën, pavarësisht se e ka cituar atë. Gjithashtu, mbrojtësi i viktimave argumenton se, ndërsa nxjerrja e formularëve të kërkesave para GJPN-së është rutinë, sistemi që zbatohet për paraqitjen e kërkesave të viktimave është i ndryshëm nga ai i DHS-së.²³

15. Në qoftë se Kërkesa do të miratohej, mbrojtësi i viktimave: (i) thekson nevojën për të zbatuar masat mbrojtëse të autorizuara për dëshmitarët me status të dyfishtë dhe kërkon që të përfshihet në procesin e redaktimit të kërkesave të dëshmitarëve me status të dyfishtë përpara se të nxirren për Mbrojtjen;²⁴ (ii) nuk kundërshton kontaktin me ZPS-në dhe Zyrën Administrative për të identifikuar dëshmitarët me status të dyfishtë dhe thekson se çdo urdhër i tillë duhet të jetë urdhër gjyqësor i përhershëm për të thjeshtuar zhvillimin e procesit në lidhje me dëshmitarët e mundshëm me status të dyfishtë që ende nuk janë pranuar si viktima pjesëmarrëse;²⁵ (iii) parashton se masat mbrojtëse aktualisht në fuqi në lidhje me viktimat pjesëmarrëse përfshijnë anonimitetin sipas rregullës 80(4)(e)(i) të Rregullores, dhe dhënia e formularëve të kërkesave dhe të dokumenteve mbështetëse në formë të paredaktuar ZPS-së, për rrjedhojë, do të kërkonte modifikimin e masave mbrojtëse në fuqi;²⁶ dhe (iv) parashton se ZPS-ja duhet të bëjë redakte jostandarde në përputhje me detyrimin e vet për nxjerrje informacioni në zbatim të masave mbrojtëse në fuqi dhe, në përputhje me qasjen e Dhomës Gjyqësore të GJPN-së në çështjen *Lubanga*, të urdhërohet që t'ia japë

²² Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 2, 9, 16.

²³ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 9-11.

²⁴ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 2.

²⁵ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 7.

²⁶ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 8.

këto redaktime jostandarde mbrojtësit të viktimave për miratim përpara se të nxirren për Mbrojtjen.²⁷

16. Së fundi, mbrojtësi i viktimave parashtron se, pavarësisht nga rezultati i Kërkesës, mund të jetë e përshtatshme që ZPS-ja edhe mbrojtësi i viktimave të kenë një listë të konfirmuar të dëshmitarëve me status të dyfishtë, pasi një listë e tillë do t'i lejonte ZPS-së që të informonte mbrojtësin e viktimave kur mbrojtja dëshiron të intervistojë një dëshmitar me status të dyfishtë, statusi i të cilit është i panjohur për Mbrojtjen.²⁸ Gjithashtu, mbrojtësi i viktimave rezervon të drejtën për të kërkuar vazhdimin e masave mbrojtëse për dëshmitarët me status të dyfishtë, përfshirë sipas rregullës 80(4)(e)(i) dhe (ii) të Rregullores.²⁹

D. KUNDËRPËRGJIGJJA E MBROJTJES SË THAÇIT

17. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se, bazuar në nenin 22(6) të Ligjit, rregullat 80(1), 81, 102, 103, 113 dhe 114 të Rregullores dhe nenet 6(1) dhe (4) të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ka të drejtë që të nxirren për të kodet e dëshmitarëve dhe formularët e kërkesave të dëshmitarëve me status të dyfishtë, nëse është e nevojshme në formë të redaktuar.³⁰ Mbrojtja e Thaçit argumenton se rregulla 113(1) e Rregullores është rregull e përgjithshme që ka të bëjë vetëm me “viktimat” dhe jo me dëshmitarët me status të dyfishtë. Në mungesë të ndonjë dispozite ligjore konkrete të përshtatshme për dëshmitarët me status të dyfishtë, ajo parashtron se rregulla 113 e Rregullores, që ka të bëjë vetëm me “Pranimin si Viktimë Pjesëmarrëse në Proces”, nuk e pengon Gjykatësin e Procedurës Paraprake të urdhërojë nxjerrjen e

²⁷ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 12-14 i referohet ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1637, Trial Chamber I, [Decision on the defence application for disclosure of victims applications](#), 21 January 2009, para. 13.

²⁸ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 7.

²⁹ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 15.

³⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 2.

kodeve të dëshmitarëve dhe formularët e kërkesave të dëshmitarëve me status të dyfishtë kur është i nevojshëm garantimi i një procesi të drejtë për të akuzuarit.³¹

18. Mbrojtja e Thaçit argumenton më tej se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë, në bazë të rregullës 81 të Rregullores, të ndryshojë masat mbrojtëse, përfshirë në rast të mosdhënies së pëlqimit nga personat e mbrojtur, “kur kjo përlijet nga rrethana të ngutshme ose kur mosndryshimi i tyre mund të çojë në gabim gjyqësor”.³² Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit kundërshton mbështetjen e ZPS-së në vendimet e mëparshme të DHS-së ku ishte urdhëruar mosnxjerrja e formularëve të kërkesave dhe anonimitetin e viktimave, pasi këto vendime nuk kishin lidhje me çështjen konkrete të dëshmitarëve me status të dyfishtë.³³ Ajo më tej pretendon se mbështetja e ZPS-së në nenin 218(2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës është e papërshtatshme pasi ai zbatohet vetën në fazat e hershme të procesit penal dhe për rrjedhojë nuk e pengon mjetin ligjor të kërkuar.³⁴

19. Mbrojtja e Thaçit parashtron se nxjerrja e materialit duhet të ndodhë në këtë fazë të procesit pasi: (i) ZPS-ja ka njoftuar listën e dëshmitarëve dhe dosjen e vet paraprake; (ii) ZPS-ja më në fund ka përfunduar, të paktën në parim, nxjerrjen e çdo materiali të rregullës 102(1); dhe (iii) në kohën e Kundërpërgjigjes së Thaçit, ekipet e Mbrojtjes ishin ftuar që të jepnin vlerësim se kur do të ishin gati të dorëzonin dosjet e tyre paraprake dhe se kur kishin filluar të punonin në këtë drejtim.³⁵ Mbrojtja e Thaçit shton se është i parëndësishëm fakti që vazhdon procesi i paraqitjes së kërkesave për praninë si viktimë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Mbrojtja e Thaçit argumenton se në këtë moment po rishikon të gjithë materialin e nxjerrë që ka të bëjë me dëshmitarët e ZPS-së. Ajo

³¹ Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 4 argumenton se, në bazë të nenit 22(6) të Ligjit dhe rregullës 80 të Rregullores, pjesëmarrja e viktimave dhe/ose masat mbrojtëse nuk duhet të cenojnë, as të bien ndesh me të drejtat e të akuzuarve.

³² Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 4.

³³ Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 7.

³⁴ Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 9-10.

³⁵ Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 8.

argumenton se çdo nxjerrje me vonesë e deklaratës së mëparshme të një dëshmitari të Prokurorisë, përfshirë formularët e kërkesave, do të kërkonte nga Mbrojtja përsëritjen e këtij veprimi, gjë që mund të vonojë më shumë procesin dhe, për rrjedhojë, të dëmtojë aftësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur.³⁶

20. Në lidhje me "rrezikun objektivisht të arsyeshëm", që për ligj mosnxjerrjen e formularëve të kërkesave dhe identitetet e viktimave në vendimet e mëparshme, Mbrojtja e Thaçit thekson se nuk kërkon nxjerrjen e identitet të dëshmitarëve me status të dyfishtë, në këtë fazë, në qoftë se është miratuar nxjerrja me vonesë e identitetit të tyre si dëshmitarë të ZPS-së.³⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

21. Në bazë të nenit 21(2) dhe (4)(c) të Ligjit, të akuzuarit gëzojnë të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik dhe t'u jepet kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tyre.

22. Në bazë të nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullës 80(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *proprio motu* ose me kërkesë të një pale, mund të urdhërojë marrjen e masave të duhura për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore, si dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët. Në bazë të rregullës 80(4) të Rregullores, masa të tilla mund të përfshijnë mosnxjerrjen për palët të materialit ose informacionit që mund të çojë në identifikimin e viktimës pjesëmarrëse në procesin gjyqësor. Masat mbrojtëse të urdhëruara nga Trupi Gjyqësor gjatë procesit mund të ndryshohen sipas nevojës.

³⁶ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 8.

³⁷ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 11.

23. Në bazë të nenit 39(11) të Ligjit dhe rregullës 95(2)(h) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, kur është e nevojshme, mund të marrë vendime mbi mocionet në lidhje me mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe dëshmitarëve, të paraqitura përpara kalimit të dosjes gjyqësore Trupit Gjykues.

24. Në bazë të rregullës 113(1) të Rregullores, pas konfirmimit të aktakuzës dhe në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes, një person që pretendon se është viktimë e një vepre penale të pretenduar në aktakuzë, mund të bëjë kërkesë për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces, ku saktëson se si i përmbush kriteret si viktimë dhe jep vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm. Formularët e kërkesave nuk u bëhen të njohura palëve.

25. Në bazë të rregullës 113(2) të Rregullores, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave ("ZPV") regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia dorëzon ato Gjykatësit të Procedurës Paraprake së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si dhe kërkesën për masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit.

26. Në bazë të rregullës 114(4) të Rregullores, kurdoherë që preken interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në proces, dhe nëse Rregullorja nuk parashikon ndryshe, mbrojtësi i viktimave, nën mbikëqyrjen e Trupit Gjykues, bën parashtrime me gojë dhe me shkrim.

IV. DISKUTIM

27. Ndonëse në kohën e marrjes së Kërkesës Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte pranuar 20 viktima pjesëmarrëse dhe për këtë arsye Kërkesa zbatohet vetëm për ata individë,³⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se konstatimet e mëposhtme vlejnë edhe për të gjitha viktimat, të cilave që atëherë u është

³⁸ *Shih* Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 85(a); Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 70(a).

miratuar,³⁹ ose do t'u miratohet pjesëmarrja dhe që janë gjithashtu dëshmitarë në këtë çështje.

A. NXJERRJA E FORMULARËVE TË KËRKESAVE TË VIKTIMAVE ME STATUS TË DYFISHTË PËR PALËT

28. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, para së gjithash, zbaton instrumentet juridike të kësaj Gjykate,⁴⁰ që përcaktojnë shprehimisht në rregullën 113(1) të Rregullores se “formularët e kërkesave nuk u bëhen të njohura palëve”.⁴¹ Ndonëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranon se praktika në GJPN është që të nxirren për Mbrojtjen formularët e kërkesave të viktimave, përfshirë ato të dëshmitarëve me status të dyfishtë, gjatë procesit të paraqitjes së kërkesave,⁴² Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se një precedent i tillë nuk është i zbatueshëm në DHS, pasi mosnxjerrja e formularëve të kërkesave për palët përcaktohet shprehimisht nga Rregullorja.

29. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje argumentin e Mbrojtjes së Thaçit se ZPS-ja ka detyrimin të nxjerrë formularët e kërkesave të dëshmitarëve me status të dyfishtë për Mbrojtjen në përputhje me rregullat 102 dhe/ose 103 të Rregullores.⁴³ Gjithsesi, rregulla 113(1) e Rregullores shprehimisht përjashton nxjerrjen e formularëve të kërkesave të viktimave për palët. Rrjedhimisht, formularët e kërkesave të viktimave përjashtohen nga detyrimi i ZPS-së për nxjerrje informacioni, pasi rregulla 113(1) e Rregullores pamundëson

³⁹ *Shih* Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 50(a) ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi 12 viktima pjesëmarrëse të tjera; Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 73(a) ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi 12 viktima pjesëmarrëse të tjera.

⁴⁰ Neni 3(2) i Ligjit. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00412, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara*, 22 korrik 2021, para. 89.

⁴¹ *Shih gjithashtu* Vendimi i Gjykatës së Apelit, poshtëshënimi 108 *ku referohet* se palët nuk kanë qasje në formularët e kërkesave sipas rregullës 113(1)-(3) të Rregullores.

⁴² *Shih* rregullën 89(1) e Rregullores së Procedurës dhe Provave të GJPN -së.

⁴³ Kërkesa, para. 14; Kundërpërgjigja, para. 8, 11.

që ato të jenë në posedim të ZPS-së.⁴⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, për rrjedhojë, informacioni i dhënë nga viktimat pjesëmarrëse nuk është objekt i të njëjtit sistem për nxjerrje informacioni si materiali dhe informacioni që posedon ZPS-ja.⁴⁵

30. Po ashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk është bindur nga argumenti i Mbrojtjes së Thaçit se rregulla 113 e Rregullores trajton vetëm pranimin e viktimave pjesëmarrëse dhe se për rrjedhojë, formularët e kërkesave të viktimave mund të nxirren për Mbrojtjen.⁴⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se formularët e kërkesave të viktimave kanë qëllim të kufizuar dhe, si dokumente administrative, kanë kryesisht për qëllim që t'i mundësojnë Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe Trupit Gjykses të vlerësojnë nëse viktimat parashtruese të kërkesave për pjesëmarrje duhet të pranohen për të marrë pjesë në procesin gjyqësor.⁴⁷ Nuk synohet që formularët e kërkesave të viktimave të përdoren si provë në këtë çështje dhe nuk synohet të përdoren për të grumbulluar informacion të rëndësishëm për përgatitjen e Mbrojtjes.⁴⁸ Përkundrazi, ky

⁴⁴ *Shih* neni 21(6) i Ligjit që përcakton se i akuzuari ka të drejtë që t'i vihen në dispozicion "të gjitha provat ose faktet materiale dhe relevante që i posedon Zyra e Prokurorit të Specializuar të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit" (theksimi i shtuar). E njëjta vlen dhe për rregullën 102(3) të Rregullores (i referohet "çdo materiali dhe prove që ka në zotërim" ose "çdo sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen e Prokurorit të Specializuar") dhe rregulla 103 e Rregullores (i referohet informacionit "nën ruajtjen, kontrollin ose dijeninë faktike të Prokurorit të Specializuar").

⁴⁵ *Shih* Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 38; *Shih në mënyrë të ngjashme* ICC, *Prosecutor v. William Samoei Ruto, Henry Kiprono Kosgey and Joshua Arap Sang*, ICC-01/09-01/11-169, Pre-Trial Chamber II, [Decision on the Defence Requests in Relation to the Victims' Applications for Participation in the Present Case](#), 8 July 2011, paras 9-11.

⁴⁶ Kundërpërgjigjja, para. 4.

⁴⁷ *Për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-2012-Red, Trial Chamber III, [Public redacted version of the First decision on the prosecution and defence requests for the admission of evidence, dated 15 December 2011](#), 9 February 2012, para. 101; *Situation in Uganda*, ICC-02/04-101, Pre-Trial Chamber II, [Public Redacted Version of Decision on victims' applications for participation a/0010/06, a/0064/06 to a/0070/06, a/0081/06 to a/0104/06 and a/0111/06 to a/0127/06](#), 10 August 2007, para. 13.

⁴⁸ *Shih* Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 38. Për këtë arsye palët nuk marrin formularët e kërkesave, por vetëm raportin e ZPV-së, për të cilin kanë të drejtë, sipas rregullës 113(3) të Rregullores, të bëjnë parashtrime të kufizuara në lidhje me aspektin ligjor të pranueshmërisë dhe përfaqësimit të përbashkët. *Shih në mënyrë të ngjashme* ICC, *Prosecutor v. Mahamat Said Abdel Kani*, ICC-01/14-01/21-171, Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr Mahamat Said Abdel Kani against the](#)

grumbullim informacioni arrihet përmes procesit të nxjerrjes së informacionit. Çka është me rëndësi, ndryshe nga një dëshmitar, viktimave parashtruese e kërkesës nuk është e informuar për të drejtat e veta⁴⁹ dhe formulari i kërkesës, përfshirë dokumentacionin mbështetës, mund të përdoret si provë në procesin penal. Për të njëjtat arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton gjithashtu se formularët e kërkesave të viktimave nuk përbëjnë “deklarata të mëparshme”, sikurse u argumentua nga Mbrojtja e Thaçit.⁵⁰

31. Gjithashtu, interpretimi i mësipërm nuk cenon ose nuk bie ndesh me të drejtat e të akuzuarve, pasi Mbrojtja ka të drejtë të marrë në pyetje dhe verifikojë dëshmitarët me status të dyfishtë gjatë gjykimit bazuar në dëshminë dhe materialin tjetër të shkëmbyer midis palëve.

32. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se formularët e kërkesave të viktimave nuk do të nxirren as për ZPS-në, as për Mbrojtjen, dhe për rrjedhojë, hedh poshtë këtë pjesë të Kërkesës. Rrjedhimisht dhe për të njëjtat arsye, kërkesa për të urdhëruar ZPS-në që të bëjë redaktime në formularët e kërkesave të viktimave dhe materialin mbështetës hidhet poshtë.

decision of Pre-Trial Chamber II of 16 April 2021 entitled “Decision establishing the principles applicable to victims’ applications for participation”, 14 September 2021, para. 51; Prosecutor v. Bosco Ntaganda, ICC-01/04-02/06-449, Trial Chamber VI, [Decision on victims’ participation in trial proceedings](#), 6 February 2015, para. 36; Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo, ICC-01/05-01/08-2012-Red, Trial Chamber III, [Public redacted version of the First decision on the prosecution and defence requests for the admission of evidence, dated 15 December 2011](#), 9 February 2012, paras 100-101; Situation in Darfur, Sudan, ICC-02/05-110, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the Requests of the OPCD on the Production of Relevant Supporting Documentation Pursuant to Regulation 86\(2\)\(e\) of the Regulation of the Court and on the Disclosure of Exculpatory Materials by the Prosecutor](#), 3 December 2007, paras 6, 20.

⁴⁹ *Shih* rregullat 42-44 të Rregullores.

⁵⁰ *Për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-2012-Red, Trial Chamber III, [Public redacted version of the First decision on the prosecution and defence requests for the admission of evidence, dated 15 December 2011](#), 9 February 2012, para. 101.

B. NXJERRJA E KODEVE TË DËSHMITARËVE ME STATUS TË DYFISHTË

33. Mbrojtja e Thaçit kërkon nxjerrjen e kodeve të dëshmitarëve me status të dyfishtë, çka do të ndikonte në sistemin (sistemet) e masave mbrojtëse në fuqi.

34. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se ka dy sisteme për masa mbrojtëse: masa mbrojtëse për mbrojtjen e dëshmitarëve të ZPS-së, dhe masa mbrojtëse për mbrojtjen e viktimave pjesëmarrëse. Rrjedhimisht, masat mbrojtëse mund të zbatohen, sikurse autorizohen, njëkohësisht për dëshmitarët me status të dyfishtë.

35. Masat mbrojtëse në fuqi për viktimat pjesëmarrëse janë të ndryshueshme, duke marrë parasysh fazën e procesit dhe modalitetin e pjesëmarrjes, sipas nenit 22 të Ligjit dhe rregullës 114 të Rregullores, dhe mund jetë e nevojshme që të rivlerësohen.⁵¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, kur autorizoi mosnxjerrjen e identiteteve të viktimave pjesëmarrëse, përfshirë dëshmitarët me status të dyfishtë, këto masa mbrojtëse u autorizuan “pa cenuar asnjë vendim procedural të ardhshëm të Trupit Gjykues dhe pa cenuar asnjë masë tjetër shtesë që rrjedh nga statusi i mundshëm i dyfishtë i tyre”.⁵² Duke marrë parasysh se së shpejti çështja do të kalojë në gjykim,⁵³ dhe viktimat pjesëmarrëse me status të dyfishtë janë thirrur për të dëshmuar në sallën e gjyqit, me mundësinë për t’i implikuar të akuzuarit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të bazuar kërkesën e Mbrojtjes⁵⁴ se, në parim, atyre duhet t’u jepen kodet e dëshmitarëve me status të dyfishtë për t’u përgatitur për gjykim.⁵⁵

⁵¹ *Shih* Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 47, 49.

⁵² Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 67; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 50; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 40; Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 61.

⁵³ KSC-BC-2020-06, F01131, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Njoftim në Përputhje me Rregullën 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave*, 30 nëntor 2022, publik.

⁵⁴ Kërkesa, para. 16.

⁵⁵ Neni 21(2), (4)(c) dhe (f) i Ligjit. *Për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v Dominic Ongwen*, ICC-02/04-01/15-471, Trial Chamber IX, [Decision on Disclosure of Victims’ Identities](#), 17 June 2016, para. 13.

36. ZPS-ja dhe mbrojtësi i viktimave kanë vetëm njohuri të kufizuara mbi statusin e individëve që kanë status të dyfishtë për shkak të masave mbrojtëse në fuqi.⁵⁶ Aktualisht, masat mbrojtëse për viktimat pjesëmarrëse janë gjithëpërfshirëse dhe të urdhëruara kundrejt të dyja palëve,⁵⁷ ndërsa masat mbrojtëse për dëshmitarët e ZPS-së janë urdhëruar kundrejt Mbrojtjes dhe do të hiqen përfundimisht sipas afatit të miratuar në vendimet përkatëse. Mbrojtësi i viktimave, i cili ka qasje në të gjitha parashtrimet e protokolluara dhe materialet të klasifikuara si konfidenciale në dosjen e çështjes,⁵⁸ ka të njëjtin nivel njohurish si Mbrojtja sa u përket aspekteve që lidhet me dëshmitarët.

37. Për të arritur që kodet e dëshmitarëve me status të dyfishtë të nxirren për Mbrojtjen, duhet të ndryshojë masa mbrojtëse e autorizuar për individët si viktimë pjesëmarrëse në bazë të rregullës 80(4)(e)(i) të Rregullores, konkretisht, mosnxjerrja e identitetit të tyre për palët dhe të akuzuarit gjatë gjithë procesit gjyqësor.

38. Mbrojtja e bazon kërkesën për ndryshimin e masave mbrojtëse në rregullën 81 të Rregullores. Kjo rregull nuk zbatohet në këtë kontekst pasi masat mbrojtëse për *viktimat pjesëmarrëse* nuk janë urdhëruar në procese të tjera gjyqësore të DHS-së ose në një juridiksion tjetër, por në këtë çështje gjyqësore. Rrjedhimisht,

⁵⁶ *Shih në mënyrë të ngjashme* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave; Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave; KSC-BC-2020-06, F00885/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Versionit të Korrigjuar dhe me më Pak Redaktime të Listës së Dëshmitarëve*, 18 korrik 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00885/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Versionit të Korrigjuar dhe Versionit me më Pak Redaktime të Listës së Dëshmitarëve*, 18 korrik 2022, konfidenciale.

⁵⁷ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 85(g); Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 70(f); Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 50(e); Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 73(e).

⁵⁸ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 82 (“mbrojtësi i viktimave ka të drejtë të shohë të gjithë dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet dhe materialet provuese të klasifikuara si publike dhe konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të dosjes së çështjes”).

baza ligjore për ndryshimin e masave mbrojtëse të viktimave pjesëmarrëse janë neni 39(11) i Ligjit dhe rregulla 80 e Rregullores.

39. Bazuar në kompetencën që ka për ndryshimin e masave mbrojtëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos që (i) identitetet e viktimave pjesëmarrëse që janë gjithashtu dëshmitarë të ZPS-së të nxirren për ZPS-në;⁵⁹ dhe (ii) sipas rregullës 80(4)(e)(i), masat për viktimat pjesëmarrëse që janë gjithashtu dëshmitarë të ZPS-së të përputhen përkohësisht me masat mbrojtëse të autorizuara për ta si dëshmitarë të ZPS-së. Ndryshimi i mësipërm do t'u mundësojë ZPS-së dhe mbrojtësit të viktimave të kontaktojnë njëri-tjetrin dhe të identifikojnë dëshmitarët me status të dyfishtë. Ai gjithashtu do t'i mundësojë Mbrojtjes, kur identitetet e dëshmitarëve të ZPS-së të nxirren për Mbrojtjen (për shembull, 30 ditë para dhënies së dëshmisë), që në të njëjtën kohë të mësojë identitetet e dëshmitarëve me status të dyfishtë.

40. Mbrojtësi i viktimave dhe ZPS-ja, pas këshillimit me njëri-tjetrin, duhet të dorëzojnë një listë konfidenciale dhe *ex parte* të dëshmitarëve me status të dyfishtë deri **të premtën, 13 janar 2023**. Kjo listë duhet t'i vihet në dispozicion Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve dhe ZPV-së.

41. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të nevojshme që mbrojtësi i viktimave të informojë dëshmitarët me status të dyfishtë për ndryshimin e masave mbrojtëse në lidhje me viktimat. Nëse dëshmitarët me status të dyfishtë kanë shqetësime, mund t'ia paraqesin ato Trupit Gjykses deri **të hënën, 23 janar 2023**. Kur të paraqesin shqetësimet, dëshmitarët me status të dyfishtë duhet të japin arsye të hollësishme duke mbajtur parasysh faktin se identitetet e tyre (si dëshmitarë) janë të njohura për ZPS-në dhe ose janë nxjerrë tashmë për Mbrojtjen,

⁵⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e konsideron problematik faktin që ZPS-ja të mësojë identitetin e viktimave pjesëmarrëse me status të dyfishtë, pasi dëshmitarët e ZPS-së janë të njohur për të.

ose do të nxirren për Mbrojtjen kur masat mbrojtëse për ta (si dëshmitarë) të pushojnë së qeni në fuqi.

42. Më pas, nëse nuk ka shqetësime, lista e dëshmitarëve me status të dyfishtë do t'i jepet në mënyrë konfidenciale Mbrojtjes.

43. Më tej, e njëjta procedurë zbatohet në lidhje me çdo individ për të cilin do të miratohet statusi i viktimës pjesëmarrëse dhe i cili ka status të dyfishtë. Pas pranimit si viktimë pjesëmarrëse, mbrojtësi i viktimave do t'i drejtohet ZPS-së dhe, nëse është e nevojshme, do të përditësojë listën e dëshmitarëve me status të dyfishtë. Brenda dy javësh mbrojtësi i viktimave do të informojë klientët e tij dhe, nëse nuk ka shqetësime, lista e përditësuar e dëshmitarëve me status të dyfishtë do t'i jepet në mënyrë konfidenciale Mbrojtjes.

C. ZGJATJA E AFATIT PËR LEJE PËR APELIM

44. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në përputhje me rregullën 77(1) të Rregullores, kur një palë kërkon të apelojë një vendim që nuk është i apelueshëm sipas Ligjit dhe Rregullores, pala në fjalë i parashton kërkesë për leje për apelim panelit që ka lëshuar vendimin e kundërshtuar, brenda shtatë (7) ditësh prej daljes së vendimit. Duke marrë parasysh pushimin e ardhshëm dimëror të gjykatës,⁶⁰ sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e mendon të përshtatshme ta ndryshojë afatin për paraqitjen e kërkesës për leje për apelim të këtij vendimi. Rrjedhimisht, një kërkesë e tillë duhet të dorëzohet deri **të hënën, 9 janar 2023**. Çdo përgjigje dhe kundërpërgjigje lidhur me të duhet të respektojë afatet e përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

⁶⁰ Pushimi dimëror është nga e hëna, 19 dhjetor 2022 deri të premten, 6 janar 2023, *shih* KSCP-2021, F00002, Kryetarja, *Periudhat e Pushimit të Gjykatës për Vitin 2022*, 11 nëntor 2021, f. 2, publike.

V. KLASIFIKIMI

45. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë një version të redaktuar publik të Kundërpërgjigjes jo më vonë se **të martën, 20 dhjetor 2022**.

VI. VENDIM

46. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **HEDH POSHTË** pjesërisht Kërkesën, konkretisht, kërkesën për formularët e kërkesave të viktimave dhe materialin mbështetës, si dhe kërkesën për redaktime;
- b) **MIRATON** Kërkesën sa i takon kontaktit të mbrojtësit të viktimave me ZPS-në dhe identifikimit të dëshmitarëve me status të dyfishtë dhe dorëzimit të një liste të dëshmitarëve me status të dyfishtë, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, deri **të premten, 13 janar 2023**, t'i njoftohet gjithashtu ZMMD-së dhe ZPV-së;
- c) **URDHËRON** Mbrojtësin e Viktimave të informojë dëshmitarët me status të dyfishtë se kanë ndryshuar masat mbrojtëse të tyre si viktimë pjesëmarrëse, sikurse përcaktohet në këtë vendim;
- d) **URDHËRON** Mbrojtësin e Viktimave t'i dorëzojë Trupit Gjykses çdo shqetësim të paraqitur nga dëshmitarët me status të dyfishtë, nëse kanë, deri **të hënën, 23 janar 2023**;
- e) **URDHËRON**, nëse nuk ka shqetësime, që lista e dëshmitarëve me status të dyfishtë të riklasifikohet si konfidenciale deri **të premten, 27 janar 2023**;

- f) **URDHËRON** që e njëjta procedurë të zbatohet në lidhje me çdo individ për të cilin do të miratohet statusi i viktimës pjesëmarrëse dhe i cili ka status të dyfishtë, sikurse shtjellohet në paragrafin 43;
- g) **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë një version të redaktuar publik të Kundërpërgjigjes jo më vonë se, **të martën, 20 dhjetor 2022**; dhe
- h) **NDRYSHON** afatin për paraqitjen e kërkesës (kërkesave) për leje për apelim të këtij vendimi dhe **URDHËRON** që kërkesa(t) të tilla të dorëzohen deri **të hënën 9 janar 2023**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 13 dhjetor 2022

Në Hagë, Holandë.